



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:285649

Datë: 18.06.2024

Numri i dokumentit: 05828889

Ac.nr.10561/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naim Mehulli - kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Liridon Maloku, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit: F.I. nga Gj....., që sipas autorizimit përfaqësohet nga Visar Vehapi, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës “Banka Ekonomike”, Sh.A., me seli në Prishtinë, që sipas autorizimit përfaqësohet nga Kompania e Avokatëve Arbëresh, gjegjësisht avokatët Labinot Buzuku dhe Adnan Pacolli nga Prishtina, lidhur me çështjen sipas padisë për kthim në vendin e punës dhe kompensim të të ardhurave personale, duke vendosur lidhur me ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3205/18, i datës 02.12.2020, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 11.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET pjesërisht e pabazuar ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës: Banka Ekonomike”, Sh.A., me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3205/18, i datës 02.12.2020, në piken I të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, VËRTETOHET.

II. Aprovohet pjesërisht ankesa e të paditurës Banka Ekonomike”, Sh.A., me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3205/18, i datës 02.12.2020, në piken III, të dispozitivit, në pjesën e kërkesëpadisë që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës dhe gjykohet si në vijim: OBLIGOHET e paditura Banka Ekonomike”, Sh.A., me seli në Prishtinë që paditësit F.I. nga Gj..... të i’u paguaj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 1460 euro, brenda afatit prej 7 ditëve nga marrja e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë për shpenzimet e procedurës, përtej shumës së gjykuar, REFUZOHET SI E PABAZUAR.

III. Mbetet e pashqyrtuar pika II e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.3205/18, i datës 02.12.2020, ka vendosur si në vijim:

- I. APROVOHET Pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit F.I. nga Gj....., ashtu që KONSTATOHET i kundërligjshëm Vendimi i të paditurës “Banka Ekonomike”, Sh.A., me seli në Prishtinë, vendimi me nr. 6085, i datës 30.11.2011, dhe

OBLIGOHET e paditura që paditësit, në emër të të ardhurave personale për periudhën prej 01.12.2011 e deri më 01.07.2012, t'ia paguajë shumën prej 4,244.12 euro në emër të pagave neto; 480.74 euro në emër të kontributit pensional; 343.35 euro në emër të tatimit të mbajtur në burim, apo në total, shumën prej 5,068.21 euro në emër të pagave bruto, të gjitha këto me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar, duke llogaritur nga dita e nxjerrjes së këtij Aktgjykimi, datë 02.12.2020, e deri në pagesën definitive, e të gjitha në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm;

- II. REFUZOHET PJESËRISHT E PABAZUAR kërkesëpadia e paditësit, për pjesën që ka të bëjë me kthimin në vendin e punës tek e paditura dhe REFUZOHET kërkesa për kompensimin e të ardhurave personale për periudhën nga 01.07.2012 e deri më 04.12.2020, e në shumën përtej asaj të aprovuar në pikën e I të dispozitivit, gjegjësisht për shumën prej 84,922.39 euro.
- III. DETYROHET e paditura që paditëses t'ia kompensojë shpenzimet procedurale në lartësinë prej 3,528.00 euro.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ankesën e të paditurës ta aprovoj si të bazuar, të prishet aktgjykimi i atakuar dhe lënda ti kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje.

Kundër këtij aktgjykimi jashtë afatin ligjor ka ushtruar ankesë paditësi për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e paditësit, aktgjykimin e ankimuar ta prishë dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje ose të njëjtin ta ndryshojë, duke e aprovuar në tersi kërkesëpadinë e paditësit. Gjykata e shkallës së parë me aktvendim C.nr.3205/18, i datës 09.02.2021, ka hudh poshtë si të pas afatshme ankesën e paditësit, ndaj të cilit aktvendim paditësi nuk ka parashtruar ankesë, prandaj Gjykata e Apelit nuk e trajtoi ankesën e paditësit e paraqitur kundër aktgjykimit C.nr.3205/18, i datës 02.12.2020.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datë 31.01.2012, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi, për kthimin në vendin e punës dhe kompensimin e të ardhurave personale, kundër të paditurës, me të cilën ka kërkuar që të: me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, vendimi me nr. 6085, i datës 30.11.2011, i nxjerrë nga e paditura "Banka Ekonomike", Sh.A., me seli në Prishtinë, që paditësi të kthehet në vendin e tij të punës tek e paditura me punët dhe detyrat sikurse para largimit nga puna dhe të detyrohet e paditura që paditësit t'ia kompensojë të ardhurat personale nga muaji dhjetor 2011 e deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit. Në padi, paditësi ka theksuar se me të paditurën ka qenë në marrëdhënie pune nga data 01.01.2004, në filialin e të paditurës në qytetin e Gjilanit, fillimisht në pozitën e punës si referent për kontabilitet, ndërsa nga data 01.01.2005 deri më 30.09.2007, në pozitën e punës si analist i kredive, kurse nga data 01.10.2007 e deri në ndërprerjen e marrëdhënies së punës nga e paditura, ka qenë në pozitën e punës si Koordinator i degës së të paditurës në qytetin e Gjilanit.

Me Aktgjykimin C.nr.250/12, të Gjykatës Komunale në Prishtinë, i datës 06.07.2012, gjykata kishte refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, e ndaj të cilit vendim, paditësi kishte ushtruar ankesë në gjykatën e shkallës së dytë. Me Aktvendimin CA.nr.2499/2013 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, i datës 14.03.2014, ishte prishur vendimi i gjykatës së shkallës së parë, dhe çështja ishte kthyer në rigjykim.

Në rigjykim me Aktgjykimin C.nr.932/2014, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, i datës 07.03.2016, ishte aprovuar në tërësi kërkesëpadija e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vepruar sipas Ankesës së të paditurës, me Aktvendimin CA.nr.3713/2016, të datës 12.10.2018, ka prishur vendimin e gjykatës së shkallës së parë ashtu që çështjen e ka kthyer sërish në rigjykim, duke dhënë edhe udhëzimet përkatëse për veprim në procedurë të rigjyimit.

Pasi lënda ishte kthyer në rigjykim paditësi me parashtresë dt.02.12.2020 ka precizuar kërkesëpadinë, ashtu që nga gjykata ka kërkuar që anulohet vendimi i të paditurës mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, nr. 6085, i datës 30.11.2011, dhe të obligohet e paditura që paditësin ta kthejë në vendin e tij të punës; të obligohet e paditura që paditësit t'ia kompensojë të ardhurat personale dhe të drejtat tjera ligjore për periudhën kohore prej 30.11.2011 e deri në hartimin e ekspertizës, datë 09.11.2020, dhe atë: në emër të pagave neto për periudhën e lartcekur, shumën prej 68,721.45 euro, plus kamatën ligjore për këto paga në shumë prej 5,623.10 euro, gjithsej pagat plus kamata ligjore në shumën prej 74,344.55 euro; në emër të tatimit të mbajtur në burim për pagat burim, shumën prej 7,611.02 euro; në emër të kontributit pensional shumën prej 8,035.00 euro dhe atë për periudhën prej 30.11.2011 e deri më 04.11.2020, e të gjitha në shumë të përgjithshme prej 89,990.60 euro, ndërsa sa i përket shpenzimeve, ka kërkuar shumën e përgjithshme prej 3,528.00 euro, sipas specifikimit në parashtresën për precizimin e kërkesëpadiës.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimin e të gjitha shkresave të lëndëve ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.3205/18, i datës 02.12.2020 me të cilin është aprovuar pjesërisht kërkesëpadija e paditësit duke vendosur më decidivisht sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: Në mes të palëve ndërgjyqëse, nuk ishte kontestuese se paditësi dhe e paditura kanë qenë në raport juridik të punës, ashtu që paditësi ka qenë i punësuar i të paditurës. Tutje, nuk ishte kontestuese se ky raport juridik i punës është krijuar që nga data 01.01.2004. Nuk ishte kontestuese se raporti juridik i paditësit dhe të paditurës, kishte ndryshuar në ndërkohë, me lidhjen e kontratave të reja të punës të palëve ndërgjyqëse, kontrata këto të administruara gjatë procesit gjyqësor, e që janë pjesë edhe e shkresave të lëndës. Me këto kontrata, raporti juridik i punës mes paditësit dhe të paditurës, ishte ndryshuar me vullnetin e të dyja palëve ndërgjyqëse, ndryshim ky që i referohej vendit të punës së paditësit, pagës së tij, kohëzgjatjes së kontratës së punës etj. Po ashtu, në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues as fakti se, para procedurës disiplinore që qoi në ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit, paditësi kishte edhe dy masa disiplinore të shqiptuara më parë dhe atë vërejtja e datës 09.02.2011 dhe ajo e datës 02.06.2011. Po ashtu, nuk ishte kontestues as fakti se, në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së paditësit sipas vendimit të Komisionit Disiplinor, paditësi kishte qenë i sistemuar në vendin e punës Koordinator i Degës së të paditurës në Gj....., në bazë të Kontratës së punës së datës 15.04.2011, me nr. 1655, e e cila kishte afat kohëzgjatjeje nga 07.04.2011 deri më 01.07.2012, në bazë të nenit 1 të kësaj kontrate. Kontratat tjera të punës para kësaj të fundit, dëshmojnë vetëm faktin se palët ndërgjyqëse kanë qenë në raport juridik të punës mes vete,

ashtu që paditësi ka qenë i sistemuar tek e paditura në vende të punës përkatëse, me të drejta dhe obligime sikurse parashohin kontratat në fjalë. Porse, kontrata e fundit e punës, mbetet më e rëndësishmja ngase përcakton raportin që paditësi dhe e paditura kishin në kohën kur është bërë ndërprerja e marrëdhënies së punës së paditësit nga e paditura, dhe se është kjo kontrata e cila është shkëputur me vendim të të paditurës.

Tutje gjykata e shkalles së parë ka shtuar se në lidhje me anulimin e vendimit të të paditurës mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, nr. 6085, i datës 30.11.2011, gjykata aprovoi kërkesën e tillë të paditësit, ashtu që vendimi në fjalë e konstatoi të kundërligjshëm, pasi që vlerësoi se ky vendim është i kundërligjshëm dhe atë për nga përmbajtja, sepse vendimi në fjalë, i cili bazohet kryesisht në padinë disiplinore të të paditurës, si akt fillestar me të cilën fillohet procedura disiplinore, nuk përmban të gjitha elementet ligjore. Kështu, vendimi në fjalë, nuk e përmban kohën se kur janë kryer ose kur supozohet se janë kryer shkeljet e detyrave të punës nga paditësi, shkelje këto që pastaj janë kualifikuar si shkelje të rënda, me pasojë ndërprerjen e marrëdhënies së punës paditësit. Në dispozitiv të këtij vendimi, përshkruhen veprimet faktike të paditësit, por nuk përmendet se këto veprime cilin lloj të shkeljeve të rënda të detyrave të punës e kanë konsumuar. Ndërkohë që, këto përshkrime faktike të veprimeve të paditësit, nuk gjejnë mbështetje në dispozitat e aktit të brendshëm të të paditurës sa i përket natyrës së shkeljeve. Së këndejmi, asnjë nga të tri veprimet e paditësit, e të konsideruara si shkelje të rënda të detyrave të punës nga ana e paditësit, nuk përshkruhet si lloj i shkeljes së rëndë të detyrave të punës në aktin e brendshëm të të paditurës. Gjykata vlerëson se një vendim mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të shkeljeve të rënda të detyrave të punës, do të duhej që patjetër të kishte pjesë të saj, së pari përshkrimin faktik të veprimit ose veprimeve të kryer nga i punësuar (në rastin tonë, paditësi), së dyti, ky përshkrim fakti të përcaktoj se cilin lloj të shkeljes së rëndë të detyrave të punës e konsumon, shkelje kjo që duhet të përcaktohet me aktin e brendshëm të punëdhënësit (në rastin tonë, të të paditurës), dhe në fund, element esencial konsiderohet edhe koha e kryerjes së kësaj ose këtyre shkeljeve të rënda të detyrave të punës, ngase nga koha e kryerjes së shkeljes së pretenduar, pastaj varet edhe aplikimi i dispozitave ligjore materiale dhe procedurale në bazë të të cilave do të trajtohej shkelja në fjalë. Në rastin e vendimit të të paditurës (Vendimi nr. 6085, i datës 30.11.2011, me të cilin paditësi i është ndërprerë marrëdhënia e punës), nuk përmbushen këto elemente të domosdoshme. Si rrjedhim, gjykata ka vlerësuar se vendimi i tillë i të paditurës është në kundërshtim me nenin 85 dhe 86 të Ligjit të Punës, ndaj vendosi që të njëjtin ta konstatojë si të kundërligjshëm. Madje, një vendim të tillë, nuk do mund ta përlligjte as ndonjë vërejtje eventuale, që do të mund t'i ishte shqiptuar paditësit nga e paditura në ndërkohë, e para vendimit të fundit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Kjo, ngase, vendimin e të paditurës me nr. prot. 6085, i datës 30.11.2011, gjykata, *prima facie*, e konsideroi si të kundërligjor, për arsye të që u dhanë më sipër.

Sa i përket lartësisë Gjykata ka bërë nxjerrjen e ekspertizës plotësuese, duke vepruar sipas Aktvendimit të gjykatës së Apelit CA.nr. 3713/2016, të datës 12.10.2018, ashtu që, sipas propozimit të paditësit e pa kundërshtim nga e paditura, ekspertja financiare V.V., ka bërë përllogaritjen e të ardhurave personale që do të realizonte paditësit për çdo muaj veç e veç, që nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, e deri në ditën e hartimit të ekspertizës. Në hartimin e kësaj ekspertize, janë marrë parasysh edhe të dhënat nga Trusit për paditësit, ku dëshmohet nëse i njëjti ka realizuar të hyra në ndërkohë pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës nga e paditura e deri në hartimin e ekspertizës, si dhe diferencën e këtyre të hyrave me ato që do të realizonte nga e paditura sikur të ishte ende në marrëdhënie pune sipas kontratës së fundit që kishin palët ndërgjyqëse. Gjykata ia fali besimin në tërësi kësaj ekspertize, duke e cilësuar si profesionale dhe që i plotëson kushtet që gjykata të bazohet në të me rastin e vendosjes për kërkesëpadinë e paditësit. Kështu, kontrata e punës e paditësi dhe e të paditurës

(me nr. prot. 1655), ishte lidhur më 15.04.2011, e e cila kishte afat kohëzgjatjeje nga 07.04.2011 deri më 01.07.2012, me të cilën paditësi ishte i sistemuar në pozitën e punës si Koordinator i Degës së të paditurës në Gj....., dhe ku paga mujore bruto ishte përcaktuar në lartësi prej 750.00 euro. Meqë gjykata e konstatoi si të kundërligjshëm vendimin e të paditurës nr. prot. 6085, të datës 30.11.2011 mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës paditësit, gjykata vlerësoi se e paditura ka për obligim që ta kompensojë paditësin për periudhën e kohëzgjatjes së kontratës, dhe atë nga ndërprerja, datë 01.12.2011, e deri në ditën e skadimit të saj, datë 01.07.2012. Duke pas parasysh të ardhurat e paditësit të përcaktuara me këtë kontratë dhe atë që ka realizuar i njëjti gjatë periudhës kohore në fjalë, gjykata vlerësoi se paditësi duhet të kompensohet për të ardhurat personale në lartësi prej 4,244.12 euro në emër të pagave neto; 480.74 euro në emër të kontributit pensional; 343.35 euro në emër të tatimit të mbajtur në burim, apo në total, shumën prej 5,068.21 euro në emër të pagave bruto. Me rastin e vendosjes kësaj, gjykata pati parasysh edhe faktin se paditësi, për muajin qershor 2012, kishte realizuar të hyra personale nga kompania “NewCo Integj”, LLC., dhe atë në lartësi të pagës neto prej 400.03 euro neto, kontributeve prej 44.26 euro. Si rrjedhim, kur gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit sa i përket pagave nga muaji dhjetor 2011 e deri më 01.07.2012, nga kjo përllogaritje minusoi të hyrat që paditësi ka realizuar në muajin qershor 2012 nga kompania në fjalë. Vlerën e kërkesëpadisë së aprovuar, gjykata e përllogariti duke u bazuar në të dhënat nga ekspertiza financiare, e cila ka përcaktuar saktë të hyrat e paditësit që do t'i realizonte nga e paditura dhe ato që, në ndërkohë, paditësi i ka realizuar tek subjektet e treta.

Tutje gjykata e shkalles së parë ka shtuar se në lidhje me pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë së paditësit, sa i përket kërkesës për kthim në vendin e punës, gjykata e refuzoi kërkesën e tillë të paditësit, meqë kontrata e tij e punës është me afat të caktuar, dhe e njëjta tashmë ka skaduar. Me nenin 80, par. 1 të Ligjit të Punës, është paraparë se *ën]ëse gjykata konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore, në bazë të dispozitave të këtij ligji, Kontratës Kolektive ose Kontratës së Punës, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që të ekzekutoj njërën prej këtyre dëmshpërblimeve: 1.1. t'i paguajë të punësuarve kompensimin, përveç shtesave dhe shumave tjera të cilat i takojnë punonjësit në bazë të këtij ligji, Kontratës së Punës, Kontratës Kolektive ose Aktit të Brendshëm, në shuma të tilla që gjykata i konsideron të drejta dhe adekuate, por të cilat nuk duhet të jenë më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëmshpërblimi që i takon punonjësit në kohën e shkarkimit; ose 1.2. nëse largimi nga puna vlerësohet si i paligjshëm sipas nenit 5 të këtij ligji, Gjykata mund ta rikthej të punësuarin në vendin e tij të punës dhe urdhëron kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm nga puna. Neni 5 i këtij ligji ndalon të gjitha format e diskriminimit që mund të shprehen në një raport të punësimit, e që lidhen me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës. Në rastin e paditësit, gjykata gjeti se, pavarësisht se vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së tij të punës është i kundërligjshëm, kjo (ndërprerja) nuk ka ardhur si rezultat i ndonjë forme të diskriminimit të aplikuar nga e paditura në paditësin. Për më tepër, shikuar edhe në aspektin e lirisë së kontraktimit, paditësi dhe e paditura, në cilësi të palëve kontraktuale, me kontratën e punës të datës 15.04.2011 (me nr. prot. 1655), me vullnetin e tyre të lirë, janë pajtuar për elementet e kësaj kontrate, rrjedhimisht edhe për çështjen e afatit të kohëzgjatjes së kësaj kontrate, e që ishte deri më datën 01.07.2012. Si përfundim, meqë në kohën e vendosjes meritorë lidhur me padinë e paditësit, kontrata e tij e punës ishte tashmë e skaduar, gjykata nuk mundi që të njëjtin (paditësin, pra) ta kthej në vendin e tij të punës që e ka pasur tek e paditura, para skadimit të asaj kontrate, andaj edhe e refuzoi kërkesën e paditësit sa i përket kthimit në vendin e tij të punës. Për më tepër, ani pse për gjykatën, në bazë të kontratës përkatëse të punës, mund të jetë e njohur se çfarë pozite të punës ushtronte paditësi në kohën kur marrëdhënia e tij e punës ishte ndërprerë me vendim të të paditurës, kërkesëpadia e paditësit, e precizuar gjatë procedurës gjyqësore, i referohet “kthimit në vendin e tij të punës”, por nuk*

specifikohet se cili është ai vend i punës ku duhet të kthehet paditësi. Në anën tjetër, në rastin e dhenë, gjykata e gjeti të paaplikueshëm edhe dispozitën e nenit 10, par. 4 të Ligjit të Punës, që përcakton se *kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore*, ngase marrë parasysh kohën e fillimit të marrëdhënies së punës mes paditësit dhe të paditurës, e që është data 01.01.2004, e deri në kontratën e fundit mes tyre, e që është kontrata e datës 15.04.2011, paditësi dhe e paditura nuk kishin një historik punësimi mes tyre për një periudhë dhjetëvjeçare, siç përcakton dispozita e lartcekur, madje nuk ishte dhe aq afër arritja e një periudhe të tillë. Sa i përket kompensimit në emër të të ardhurave personale që i referohet periudhës prej 01.07.2012, e që është dita e skadimit të kontratës së punës së paditësit, e deri më 09.11.2020, e që është dita e hartimit të plotësimit të ekspertizës financiare, gjykata e refuzoi këtë pjesë për arsye se paditësi nuk ka një bazë juridike nga e cila do të mund ta realizonte kompensimin e tillë. Së këndejmi, meqë kontrata e punës e paditësit ishte me afat të skaduar, dhe meqë kthimi në vendin e tij të punës që e ushtronte tek e paditura nuk mund të bëhet për arsyet e shpjeguara më lart, gjykata e refuzoi si të pabazuar kërkesën e paditësit për kompensim të të ardhurave personale në këtë pikë, të ardhura këto që kapin shumën e përgjithshme prej 84,922.39 euro, e ku përjashtohet shuma prej 4,244.12 euro si shumë e aprovuar pjesërisht e kërkesëpadisë së paditësit.

Në lidhje me kamatën e gjykuar, gjykata u bazua në nenin 277, par. 1 të LMD-së, duke e gjykuar të njëjtën në lartësinë që e paguajnë bankat vendore si për deponimet për kursim në afat mbi një vit, pa destinim të caktuar, ashtu që e njëjta do të fillojë të llogaritet nga data 02.12.2020, e që është data kur është nxjerrë ky aktgjykim, e deri në pagesën definitive.

Ndërsa vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të përfaqësuesit të autorizuar të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të përfaqësuesit të autorizuar të paditurës për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse Gjykata e Apelit nga shqyrtimi i shkresave të lëndës në mënyrë të pa kontestuar e ka vërtetuar faktin se paditësi me të paditurën fillimisht ka themeluar marrëdhënie juridike të punës në bazë të kontratës e datës 01.01.2004. Po ashtu palët kanë themeluar marrëdhënie juridike të punës në bazë të Kontratës te fundit me nr. 1655 e datës 15.04.2011 në kohë të caktuar në kohëzgjatje deri me dt.01.07.2012 në punët dhe detyrat e punës si koordinator i Degës në Gjilan. Në bazë të kësaj kontrate, palët kanë hyrë në marrëdhënie juridike të punës dhe të njëjtit kanë pasur obligim që tu përmbahen të drejtave dhe detyrimeve që kanë dal nga kontrata e lidhur. E paditura me vendimin me nr. 6085 të datës 30.11.2011, përveç tjerash ka ndërprerë kontratën e punës, pa periudhë paralajmërimi - njoftimi, me arsyetim si në vendim.

Paditësi me datë 07.12.2011 ka paraqitur ankesë për rishqyrtimin e vendimit për ndërprerje të mardhenjës së punës . E paditura sa i përket ankesës së paditësit, me njoftim të datës 06.01.2012 ka refuzuar ankesën e punëmarrësit. Paditësi brenda afatit ligjor në gjykatën e shkallë së parë me datë 31.01.2012, ka paraqitur padi.

Gjykata e Apelit e mbështet në tërsi si të drejtë dhe të ligjshëm vendimin e Gjykatës së shkallës së parë për faktin se e njëjta drejt ka vendosur kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, sepse e paditura në mënyrë të kundërligjshme ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës paditësit, sepse në veprimet e tij nuk përmbushen elementet të shkeljeve të rënda të detyrave të punës në mënyrë që të konstatohet se të njëjtit do të duhej ti shkëputej marrëdhënia e punës.

Nga shkresat e lendes është provuar fakti se paditësi ka vepruar në kuadër të detyrave të tij të punës dhe se nuk ka qenë përgjegjësi e tij për shkeljeje e pretenduara të të paditurës, paditësi ka vepruar konform detyrave të tij të punës të cilat i janë parashtruar dhe se përgjegjësia e supozuar e të paditurës bie në punëtor të tjerë ku kjo është vërtetuar edhe me aktgjykim penal se për rastin për të cilin është larguar paditësi nga puna, për atë rast është shpallu fajtor me aktgjykim penal PKR.nr.64/12 dt.23.12.2015 të plotfuqishëm 23.02.2016, punëtori tjetër. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate në veprimet e paditësit nuk formohen elementet të shkeljes së rënde të detyrave të punës për faktin se i njëjti ka kryer detyrën e tij të punës.

Pra nga gjendja faktike e vërtetuar sipas administrimit të provave nuk mund të konstatohet se paditësi ka pasur veprime të keqpërdorimit në kryerjen e detyrave apo tejkalimi të kufizimeve të autorizimit të tij me qëllim të sigurimit të përfitimit jo ligjor material për vete apo ndonjë person tjetër apo ndonjë organizatë biznesore apo për të shkaktuar ndonjë dëm tek persona tjerë apo organizatat biznesore, e po ashtu nuk mund të konstatohet se ka pasur veprime të pakujdesshme në kryerjen e detyrave të tij në mënyrë që të paditurit ti shkaktoj dëme, i njëjti siç është cekur edhe me larte ka ndërmarrë veprime në mënyrë që të kryej detyrave e tije të punës si koordinator, këtë e ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë nga provat e administruar të cilat gjenden edhe në shkresat e lendes e që janë të pranueshme edhe për gjykatën ankimore.

Për Gjykatën e Apelit, vendosja direkte e të paditurës për sanksionimin e paditësit me masën me të rënde për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në raport me veprimet e paditësit, është vendimmarrje arbitrare e cila përçon sinjal të frikës dhe presionit edhe të punëtorët tjerë. Vendimi i të paditurës për ndërprerjen e mardhenjës së punës të paditësit, pa e arsyetuar mjaftueshëm vendimin për bënë cenim të të drejtave themelore nga marrëdhënie a punës dhe po ashtu cenim të të drejtave të njeriut.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se:

Me nenin 10 paragraf 1 të Ligjit të Punës, përcaktohet se: “ Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuar. Kontrata përfshin elementet e përcaktuara sipas nenit 11, të këtij ligji, me paragrafin 2 të po këtij neni, përcaktohet se: “ Kontrata e Punës mund të lidhet për: 2.1. një periudhë të pacaktuar; 2.2. një periudhë të caktuar; dhe 2.3. për punë dhe detyra specifike, ndërsa me paragrafin 3, të po këtij neni, përcaktohet se: “ Kontrata e punës që nuk përmban kurrfarë hollësish për kohëzgjatjen e vet, duhet të konsiderohet si kontratë në periudhë të pacaktuar “.

Me nenin 7 të Kontratës së Punës, me numër 1655 e datës 15.04.2011, përcaktohet se: “ pundhësi apo i punësuar, mund të ndërpritet kontrata e punës me njoftimin paraprak dhe atë: prej 30 ditë deri në 60 ditë varësisht nga kohëzgjatje e punësimit.

Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes rezulton se gjykata e shkallës së parë, drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se paditësi dhe e paditura raportin e tyre - të drejtat dhe detyrat e tyre punëdhënës - punëmarrës i kanë rregulluar me kontratë në të shkruar, duke përcaktuar saktë të drejtat dhe detyrat e tyre reciproke, gjykata ka konstatuar se kontrata e punës është

lidhur në pajtim të plotë me dispozitat ligjore të cekura me lartë, se kushtet e kontratës së punës së lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës duke marrë për bazë edhe kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës është në pajtim të plotë me dispozitat ligjore të lartcekura.

Gjykata e Apelit vlerëson se marrëdhënia e punës është marrëdhënie juridike - kontraktuese, ku palët me rastin e lidhjes së një kontrate të tillë duhet të respektojnë kushtet e kontratës si tërësi, për çka në këtë rast gjykata konstaton se kontrata e punës e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës është lidhur duke u respektuar të gjitha kushtet e përgjithshme për lidhjen e kontratës siç janë: aftësia punese e palëve kontraktuese, pajtimi i vullnetit të palëve, lënda - objekti i kontratës dhe baza e kontratës.

Gjykata e Apelit vlerëson se është parim i së drejtës se palët me vullnetin e tyre të lirë të shprehur apo me veprime konkludente mund të krijojnë raporte juridike - gjegjësisht marrëdhënie juridike, palët me vullnetin e tyre të shprehur apo me veprime konkludente mund të ndryshojnë apo të shuajnë një marrëdhënie juridike - raport juridik. Në këtë rast gjykata ankimore konstaton se kontrata e punës e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës ka mundur të ndryshohet vetëm me vullnetin e shprehur të të dyja palëve dhe se e paditura nuk ka mundur ta ç' fuqizoj kontratën vetëm me shprehjen e një anshme të vullnetit të saj dhe se vendim për ç' fuqizimin e kontratës, siç ka bërë e paditura si i tillë është i pa drejtë dhe në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore të cekura me lartë dhe në kundërshtim të plotë me kontratën e punës nr. 1655 e datës 15.04.2011 dhe se një vendim i tillë nuk mund të pranohet si pjesë e kontratës së punës gjersa të dyja palët të pajtohen për ndryshimin e kushteve të kontratës e cila duhet apo është dashur të bëhet me aneks kontratë apo kontratë të re apo të kërkohet anulimi i saj në procedurë gjyqësore, e jo siç ka bërë e paditura me vendim me shprehje të njëanshme të vullnetit.

Për lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata e shkallës së parë në cilësinë e provës materiale ka administruar ekspertizën e ekspertit financiar V.V. të datës 09.11.2020, në bazë të së cilës ka vërtetuar lartësinë e të ardhurave të munguara për paditësin si është përshkruar saktë në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, të cilës edhe kjo gjykatë ja fali besimin në tërësi, për arsye se eksperti financiar ka bërë llogaritjen pagave për periudhën kohore nga largimi i punës deri të hartimi i ekspertizës, mirëpo gjykata me të drejtë nga te dhënat nga ekspertiza e lartcekur ka marrë për bazë vetëm përdhën sa ka pasur kontratë paditësi dhe atë nga koha e largimit e deri në skadimin e kontratës duke filluar nga data 01.12.2011, e deri me datë 01.07.2012 të pagave të pa paguara paditësit. Në mendimin e tij profesional eksperti në formë të shkruar dhe tabelore, ka sqaruar periudhën kohore, për lartësinë e pagave, pagën bruto, kontributin pensional, tatimin në burim, pagën neto dhe kamatën, e të gjitha këto për secilin muaj veç e veç dhe shumën e tërësishtme, duke marrë për bazë të gjitha provat në shkresat e lëndës e veçanërisht kontratën e punës, si dhe prova tjera prezent në shkresat e lëndës.

Në kuptim të kësaj gjendje të vërtetuar faktike, gjykata e shkallës së parë, drejt ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se me nenin 55 paragraf 1 të Ligjit të Punës, përcaktohet se: “ I punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me kontratën e punës në pajtim me këtë ligj, kontratën kolektive, aktin e brendshëm të punëdhënësit ”, ndërsa me paragrafin 2, të po këtij neni, përcaktohet se: “ Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuar i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës “.

Meqenëse është vërtetuar se vendimi i të paditurës është i kundërligjshëm ashtu qe marrëdhënia e punës është ndërprerë në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe kodin disiplinor, e në anën tjetër e paditura me asnjë provë të vetme, nuk e ka argumentuar se ka përmbushur detyrimin e saj ndaj paditësit dhe duke u bazuar në këtë gjendje faktike edhe kjo gjykatë erdhi në përfundim se ekziston detyrimi juridik - civil, ndaj paditësit për kompensimin e të ardhurave personale të papaguara, në shumën si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar dhe gjen mbështetje në nenin 245 paragraf 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili përcakton se:

“ Kreditori në marrëdhënien e detyrimit, ka të drejt që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij ” dhe si rezultat i kësaj, meqenëse se e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin, e paditura ka hyrë në raport të detyrimeve me paditësin, në të cilin raport paditësi e ka cilësinë e kreditorit kurse e paditura e ka cilësinë e debitorit.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë, drejtë është aplikuar e drejtën materiale.

Gjykata e shkallës së dytë ka bërë ndryshimin e aktvendimit të shkallës së parë në pjesën sa i përket shpenzimeve të procedurës sepse gjykata e shkallës së parë gabimisht kishte aplikuar të drejtën materiale, prandaj Gjykata e Apelit e ka vendosur si në piken II, të dispozitivit, duke iu referuar nenit 453 par 1 të LPK-se ku përcaktohet se me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t'i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat. Prandaj Gjykata e shkallës së dytë vendosi që të aprovoj pjesërisht shpenzimet e procedurës duke pas parasysh shpenzimet e nevojshme apo të domosdoshme që kanë qenë në këtë çështje juridike kontestimore.

Gjykata e Apelit gjatë vlerësimit të pretendimeve ankimore, vërejti se e paditura nuk ka parashtruar pretendime në raport me piken II të aktgjykimit të atakuar në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë, prandaj kjo pika e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar ka mbetur e pa shqyrtuar, dhe se kjo Gjykatë vendosi sikurse në piken III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 194, 195 paragrafi 1 pika d) dhe e), lidhur me nenin 201 pika d) të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr. 10561/2021, me datë 11.06.2024

Kryetari i kolegjit
Naim Mehulli, d.v